



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2024:053774  
Datë: 27.01.2025  
Numri i dokumentit: 06760979

CA.nr.347/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Qerim Ademaj-kryetar i kolegjit, Bujar Doberdolani dhe Fatmir Baloku- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses/kunderpaditurës S.G nga P....., të cilën më autorizim e përfaqëson K.B.Th avokate në P....., kundër të paditurit-kunderpaditësit S.G nga P....., të cilin më autorizim e përfaqëson A.J avokat në P....., me bazë kthimin e paluajtshmërisë dhe vertetim pronësie, me propozim qe të caktohet masa e sigurimit të kërkespadiës, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditurit-kunderpaditësit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 2010/2024, i datës 03.06.2024, në seancën jopublike të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të te paditurit-kunderpaditësit S.G nga P....., ndersa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 2010/2024, i datës 03.06.2024, në pikën II (dy) dhe III (tre ) të dispozitivit VERTETOHET.

II. Aktvendimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 2010/2024, i datës 03.06.2024, në pikën I (një) te dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.1436/24, i datës 25.11.2024 ka vendosur:

I.REFUZOHET si i pathemeltë propozimi i paditëses-propzueses se masës se sigurimit S.G nga P....., më të cilën ka kërkuar qe ti ndalohet të paditurit qe banesën e cila gjendet në lagjen D....., rruga A..... H.....”, nr. .... në P....., me sipërfaqe prej

58.21 m2, me numër të njësisë kadastrale ....., të ndërmarrë ndonjë veprim më qëllim të ndryshimit të gjendjes ekzistuese faktike në pjesën e paluajtshmërisë , shitja, bartja ne persona te tretë, ngarkimi më ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike te paluajtshmërisë dhe ti ndalohet te paditurit dhe personave të tjerë të shfrytezojnë banesën e uzurpuar në mënyrë te kunderligjshme.

II. REFUZOHET si i pathemeltë propozimi i te paditurit S.G, më të cilin ka kërkuar qe te caktohet masa e sigurisë dhe i ndalohet paditëses S.G nga P....., qe ta tjetërsojë, ngarkojë dhe disponojë me pasurinë, banesën ne katin ..., hyrja nr. ...., me sipërfaqe prej 58.21 m2, me numër të njësisë kadastrale ....., e cila gjendet në lagjen D....., rruga A.H ....”, nr. ....-P....., dhe të caktohet masa e sigurisë ne llogaritë bankare të paditëses në mjetet në lartësi prej 35,000.00 euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurit-kunderpaditësit, duke e goditur për shkak te shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, apo qe i njëjti aktvendim të ndryshohet nga gjykata e shkallës së dytë, duke u aprovuar kërkesa për masë siguroese.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja-kunderpaditura.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 e lidhur me nenin 208 të LPK-së gjeti se:

*-Ankesa nuk është e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja-kunderpaditura në gjykatën e shkallës së parë më datë 15.02.2024 ka ushtruar padi kundër të paditurit-kunderpaditësit, me bazë kthimin e paluajtshmërisë, ku më rastin e ushtrimit të padisë gjykatës i ka propozuar qe te caktohet masa e sigurimit të kërkespadisë, më të cilën i ndalohet të paditurit qe banesën e cila gjendet në lagjen D....., rruga A..... H..... ”, nr. .... në P....., me sipërfaqe prej 58.21 m2, me numër të njësisë kadastrale ....., të ndërmarrë ndonjë veprim më qëllim të ndryshimit të gjendjes ekzistuese faktike në pjesën e paluajtshmërisë , shitja, bartja ne persona te tretë, ngarkimi më ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike te paluajtshmërisë dhe ti ndalohet te paditurit dhe personave të tjerë të shfrytezojnë banesën e uzurpuar në mënyrë te kunderligjshme.

I padituri-kunderpaditësi më parashtresën e datës 07.05.2024 në gjykatë kunder paditëses-kunderpaditurës ushtron kunderpadi, më bazë vertetimin e pronësisë dhe kthimin e mjeteve monetare, ku se bashku me kunderpadi ka kërkuar edhe caktimin e masës se sigurimit të kërkespadisë, më të cilin i ndalohet paditëses S.G nga P....., qe ta tjetërsojë, ngarkojë

dhe disponojë me pasurinë, banesën ne katin ..., hyrja nr. ...., me sipërfaqe prej 58.21 m2, me numër të njësisë kadastrale ....., e cila gjendet në lagjen D....., rruga A..... H..... ”, nr. ....-P....., dhe të caktohet masa e sigurisë ne llogaritë bankare të paditëses në mjetet në lartësi prej 35,000.00 euro.

Gjykata e shkallës së parë më qëllim qe te vleresojë propozimet e ndergjygsëve lidhur me msat siguruese te propozura ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore, në të cilën janë deklaruar ndergjygsësit dhe te autorizuarit e tyre, është bërë nxjerrja e provave të propozura, ku pastaj gjykata përmes vlerësimit të tyre ka ardhur në përfundimin se nuk plotesohen kushtet ligjore për aprovimin e propozimit te palëve ndergjygsëse , ku edhe bie aktvendimin e ankimuar C.nr. 2010/2024, i datës 03.06.2024, duke vendosur me decidivishtë si ne dispozitivin e të njëjtit.

Lidhur më vendosjen sipas pikës II (dy) te dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se i padituri-kunderpaditësi me provat e prezantuara para gjykatës ka bërë të besueshme të drejtën e tij subjektive si njëri prej kushteve ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 297 parg. 1 pika a) të LPK, por për gjykatën nuk ka arritur të bëjë te besueshme se ne rastin konkret ekziston rreziku se nëse nuk caktohet masa e sigurimit atij do ti shkaktohet ndonjë dëm i pariparueshëm apo se do te vështirsohet dukshëm realizimi i kërkesës se tij, si kush i dytë ligjor i përcaktuar me pikën b) te nenit 297 parg. 1 i cili duhet të plotesohet në mënyrë kumulative me kushtin e parë ligjor të potencuar si më lartë, aq me tepër kur më asnjë provë nuk ka dëshmuar se paditësja ka tentuar ose do të tentoj qe të bëjë tjetërismin e banesës lëndore në fjalë.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se sipas gjetjeve të gjykatës se shkallës së dytë rezulton se aktvendimi i atakuar në pjesën e goditur me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje të thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe nuk ka shkelje lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK. Gjendja faktike rezulton të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë dhe aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të bëra nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se propozimi për caktim të masës së sigurimit i paraqitur nga i padituri-kunderpaditësi nuk është i bazuar, përkatësisht nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në faktet e theksuara në arsyetim të aktvendimit të ankimuar rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes, prandaj Gjykata e Apelit, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi, për arsye se edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret në bazë të provave nga shkresat e lëndës të cilat janë administruar në seancën dëgjimore nga gjykata e shkallës së parë nuk kanë qenë të

plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit sikurse është parashikuar me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1, pika nën (a) dhe (b) të LPK-së.

Për lëshimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, sipas dispozitës së nenit 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së parashihet se duhet të plotësohen dy kushte kumulative. Kushti i parë është që propozuesi i sigurimit ta bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, ndërsa kushti i dytë është që të ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se ligjërisht masa e sigurimit të kërkesëpadisë çdoherë duhet të shërben për ruajtjen e një gjendje ekzistuese të gjërave, me ndryshimin e të cilave palës e cila ka propozuar caktimin e saj do të shkaktohej dëm i pariparueshëm dhe i pa kompenzueshëm ose në një formë apo tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit, me çka në rastin konkret kur kemi parasysh deklarin e palëve përkatësisht të autorizuarve të tyre bërë në seancën dëgjimore dhe vlerësimit që ju ka bërë gjykata e shkallës së parë provave shkresore të administruara, është mendim dhe vlerësim edhe i gjykatës ankimore se refuzimi i propozimit të te paditurit-kunderpaditësit për caktimin e masës të sigurimit nuk do të ketë asnjë ndikim negativ në realizimin e te drejtave të tij te pretenduara me kërkesëpadi nëse veç kërkesa e tij do te provohet si e themeltë, me çka rrjedhimisht të njëjtit në asnjë formë nuk do të pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës së saj.

Përveç kësaj kjo gjykatë me shikim ne shkresa te lëndës e pranon në tërësi përfundimin e nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë se i padituri-kunderpaditësi për gjykatën nuk ka mundur ta bënë të besueshme se ne rastin konkret ekziston rreziku se nëse nuk caktohet masa e sigurimit atij do të shkaktohet ndonjë dëm i pariparueshëm apo se do te vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës se tij, si kush i dytë ligjor i përcaktuar me pikën b) te nenit 297 parg. 1 i cili duhet të plotësohet në mënyrë kumulative me kushtin e parë ligjor të parapramë me pikën a) te nenit 297 parg. 1 të LPK, për shkak se më asnjë provë të nxjerë nga gjykata e shkallës së parë nuk është vertetuar fakti se paditësja-kunderpaditura ka ndermarrë ndonjë hap ne drejtim te shitjes apo ngarkimit më barrë te banesës lëndore në fjalë për të cilën e njëjta sipas certifikatës se pronës rezulton se është pronare, më qëllim qe gjykata në këtë fazë te procedurës te kishte një vlerësim ndryshe lidhur masën siguroese te propozuar.

Përveç kësaj kur marrim për bazë faktin se në asnjë rast vendimi i nxjerrë për masë te sigurimit të kërkesëpadisë nuk trajtohet si çështje e gjykuar në mes palëve ndergjyqjësë, në rastin konkret nëse gjatë procedurës se zhvilluar tek gjykata e shkallës së parë lidhur më vendosjen sa i përket çështjet kryesore sipas padisë se paditëses-kunderpaditëses dhe padisë se te paditurit-kunderpaditësit, njëra apo tjetra palë vlerësojnë se për shkak te rrethanave te ndryshuara mund te paraqitet si e nevojshme caktimi i ndonjë masë te sigurimit të paraprarë sipas dispozitave te LPK, nuk kanë pengesa qe gjykatës se shkallës së parë ti propozojnë sërish caktimin e masave te sigurimit të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas këtij aktvendimit ka pasur parasysh dhe ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës ankuese përmes se cilit i njëjti pretendon se në rastin konkret kanë qenë të plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit të kërkespadsisë sipas propozimit të bërë nga i padituri-kunderpaditësi, për të cilin pretendim ankimor gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se është pa ndikim për vendosje ndryshe nga ajo siç gjykata e shkallës së parë ka vendosur me aktvendimin e ankimuar, pasi që kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës dhe analizimin e aktvendimit të ankimuar konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar në bazë të fakteve të theksuara në arsyetimin e aktvendimit rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, me çka si shkak i vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, me rastin e vendosjes drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e për arsyet dhe shkaqet të cilat gjykata e shkallës së dytë i ka elaboruar veç më lartë.

Aktvendimi i ankimuar në pikën I (një) të dispozitivit nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, pasi që në këtë pjesë nuk është goditur më ankesën e ushtruar nga pala e paditur-kunderpaditësi.

Prandaj nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës ligjore nga neni 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, u vendos si dispozitivit të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
Ac.nr.347/2025, me datë 27.01.2025

Kryetari i kolegjit,  
Qerim Ademaj, d.v.